



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 06

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302

Prishtinë, më 11 shkurt 2015, në orën 11:00.

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Njomza Emini, Fikrim Damka, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Besa Baftiu, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi.

Munguan: Adem Hoxha.

Të ftuar: z. Agim Çeku, kryetar i Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të veteranëve të UÇK-së; Faik Fazliu, drejtor i Zyrës për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoit, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit, të mbajtura më datë 21, 23 dhe 28 janar 2015;**
- 3. Raportim i kryetarit të Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të veteranëve të UÇK-së, z. Agim Çeku;**
- 4. Formimi i grupit punues për monitorimin e Ligjit nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit, të mbajtura më datë 21, 23 dhe 28 janar 2015

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalet e mbledhjes së komisionit të mbajtura më 21, 23 dhe 28 janar 2015, pa vërejtje.

3. Raportim i kryetarit të Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të veteranëve të UÇK-së, z. Agim Çeku

Kryetarja – Kemi kënaqësinë që në mesin tonë të kemi prezent, z. Agim Çeku, kryetar i Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të veteranëve të UÇK-së. Ju faleminderit z. Çeku që iu keni përgjigjur ftesës së komisionit, për të raportuar lidhur me punën e Komisionit Qeveritar për verifikimin e statusit të veteranëve të UÇK-së. Andaj, ju ftojmë që para anëtarëve të Komisionit të prezantoni punën dhe angazhimin e këtij komisioni që ka bërë deri më tanë.

Agim Çeku, kryetari i Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të veteranëve të UÇK-së – Fillimisht, më lejoni t’ju falënderoj ju kryetare dhe të gjithë anëtarët tjerë të komisionit. Po ashtu, t’ju falënderoj edhe për ftesën dhe jam përgjigjur me kënaqësi për të raportuar para jush lidhur me punën dhe angazhimin që kemi pasur ne si komision për verifikimin e statusit të veteranëve të UÇK-së. Unë si kryetar i këtij komisioni, bashkë me gjithë anëtarët tjerë të komisionit, me seriozitetin më të madh iu kemi qasur kësaj detyre shumë të rëndësishme, duke e konsideruar jo vetëm si detyrë qeveritare, por edhe si obligim moral ndaj bashkëluftëtarëve tanë, që t’i verifikojmë të gjithë ata veteranë, të cilët kanë kontribuar gjatë luftës dhe që brenda mundësive, shteti t’ua njohë kontributin e tyre, dhe në njëfarë mënyre, që t’i ndihmojë ata në jetën e përditshme dhe në ballafaqimin me vështirësitë jetësore të gjithë qytetarët, në veçanti këto kategori të dala nga lufta. Besoj që jeni të informuar se ky komision ka qenë i formuar para se unë ta marrë për ta udhëhequr, por i cili nuk ka qenë funksional. Pasi që jemi ngarkuar me këtë detyrë nga ana e Qeverisë, iu kemi qasur punës me seriozitetin më të madh dhe e kemi funksionalizuar këtë komision, dhe nga ajo kohë, deri më tanë në këtë moment, nuk e kemi ndërprerë punën, edhe pse është stërvitje, por gjithë kjo është në bazë të arsyeve objektive, pra është një proces kompleks dhe gjatë këtij procesi kemi hasur në disa çështje të cilat është dashur që t’i zgjidhë Qeveria. Neve na ka marrë kohë fillimisht që si komision të përgatisim modalitetin e punës, modalitetin e verifikimit, mandej formën e aplikacioneve dhe vetë koha e aplikimit të qytetarëve. Ne kemi pranuar një numër jashtëzakonisht të madh të aplikacioneve, pra janë pranuar gjithsej 66,500 aplikacione në zyrat e shoqatave në tërë Kosovën, si dhe jashtë Kosovës. Kur i kemi sistemuar këto aplikacione, ne e kemi ditur se numri i luftëtarëve nuk është ky, por kemi vërejtur se njerëzit kanë kontribuar në forma të ndryshme, kanë qenë në shërbim të luftës, në shërbim të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë dhënë kontribut të çmueshëm përlirinë e vendit tonë dhe atëherë e kemi parë të nevojshëm se duhet t’i kategorizojmë këta qytetarë të cilët kanë aplikuar dhe secilit t’i njihet kontributi i dhënë gjatë luftës. Për kategorizimin e tyre, ne jemi pajtuar në komision, por ka munguar baza ligjore dhe ne kemi insistuar te Qeveria që së bashku me shoqatat e luftës, Zyrën ligjore dhe ish-kryeministrin z. Hashim Thaçi, personalisht kemi hartuar draft-ligjin për veteranët dhe në këtë ligj është definuar edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës, po ashtu janë definuar kategoritë e luftës, varësisht kush çfarë kontributi ka dhënë në luftë. Normalisht, kategoria kryesore është veterani luftëtar. Në këtë kategori parashihet që të jetë çdo qytetar i Kosovës dhe shtetas i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK-së dhe është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK së dhe i cili ka qenë aktiv deri në përfundimin e luftës.

Nuk është çështje e komisionit se çka do të përfitojnë dhe kush do të përfitojë. Ne si komision e kemi për detyrë vetëm të verifikojmë statusin dhe t'ua caktojmë secilit se çfarë statusi e meriton dhe në fund t'i lëshojmë një certifikatë përkatëse secilit për statusin e vet. Po ju informoj se Qeveria është duke hartuar një udhëzim administrativ, i cili parashihet me Ligjin për veteranët e UÇK-së që të nxirret dhe me këtë udhëzim do të përcaktohen format, kushtet, dëshmitë e dokumentet e nevojshme që veteranë, invalidi apo familja e dëshmorëve të aplikojë për përfitimin e asaj, që parashihet në bazë të Ligjit për veteranët e UÇK-së. Pra, ne jemi vetëm për verifikimin e statusit të tyre. Jemi në përfundim të këtij procesi dhe të hënën e kishim takimin e fundit të gjithë anëtarët e këtij komisioni, që janë përfaqësues të shoqatave apo ish-komandantë, përfaqësues të zonave apo të Shtabit të Përgjithshëm, raportuan para komisionit që deri më 20 shkurt 2015, do të përfundojë ky proces dhe do të publikohen listat. Po ashtu, po ju njoftoj se sot ka filluar publikimi i listave, fillimisht listat e dy zonave ku ka përfunduar verifikimi, listat e Zonës Operative të Llapit dhe listat e Zonës Operative të Karadakut. Sekretariati i komisionit, i cili funksionon si zyrë në kuadër të Zyrës së Kryeministrat, të cilën e udhëheq z. Faik Fazliu që njëherazi është edhe drejtor i Zyrës për Çështjet e Kategorive të Dala nga Lufta. Kjo zyrë fillimisht ka bërë sistemimin e të gjitha këtyre aplikacioneve nëpër njësi dhe i kemi ndarë nëpër zona. Mandej kemi filluar dhe kemi ftuar komendantin e zonës, komendantin e brigadës, si dhe komendantët e linjës komanduese të secilës njësi, si batalionit, kompanisë, togjeve etj. Në takim të përbashkët, aplikacion për aplikacion, kemi filluar t'i shqyrtojmë dhe i kanë verifikuar dhe kategorizuar secilin aplikant. Në këtë proces janë zhvilluar mbi 400 takime dhe diku mbi 3000 persona kanë qenë të angazhuar për verifikimin e këtyre aplikacioneve. Më duhet t'ju informoj se ne si komision, te kategoria e invalidëve, kemi bërë vetëm konstatimin dhe verifikimin se a ka qenë i plagosur apo i lënduar në detyrë, kurse sa i përket shkallës së invaliditetit dhe të drejtat që i takojnë si invalid, i gjzon në bazë të vlerësimit të komisionit përkatës profesional mjekësor.

Pra, ky është verifikimi fillestar dhe këtë verifikim e kanë bërë drejtpërdrejt komendantët e tyre dhe përgjegjësia bie mbi këta komandantë, pra mbi komendantin e zonës, komendantin e brigadës, batalioneve, kopanisë etj. Deri më tanë, komisioni ka refuzuar mbi 8000 aplikacione ku gjatë shqyrtimit të aplikacioneve asnjë komendant nuk ka mundur që të dëshmojë apo t'i njohë këta aplikantë se kur dhe ku kanë qenë të angazhuar gjatë luftës dhe si rezultat i kësaj janë refuzuar. Pas publikimit të listave, në bazë të ligjit, është afati prej 30 ditësh për parashtrimin e ankesave dhe mund të ankohet çdokush, në radhë të parë personi i cili nuk është i kënaqur me statusin e përcaktuar nga komisioni apo vetë aplikuesi të cilit iu ka refuzuar aplikacioni. Po ashtu, mund të ankohen edhe qytetarët, të cilët kanë ndonjë ankesë apo pretendim për ndonjë person të cilit i është njohur statusi i veteranit dhe s'ka qenë i angazhuar në kohën e luftës apo nuk ka shërbyer në luftë, të paraqesin ankesën dhe pretendimet e tyre, me qëllim që kjo listë të jetë sa më reale. Pra, ne si komision, në takimin e fundit e kemi themeluar një komision për shqyrtimin e ankesave i cili do t'i shqyrtojë të gjitha këto ankesa që mund të parashtronë gjatë këtij afati për ankesa. Këtë komision do ta udhëheq z. Faik Fazliu ku në këtë komision janë 5 anëtarë të përhershëm dhe dy anëtarë janë ad-hoc, varësisht prej cilës zonë është ankesa ku do të jetë anëtar, pra komandanti i asaj zonë dhe një përfaqësues i shoqatës së cilës kategori është ankesi.

Pas përfundimit të këtij afati për ankesa dhe shqyrtimit të tyre, përfundohen listat përfundimtare për këto kategori. Pas publikimit të listës përfundimtare, këto kategori kanë të drejtë për aplikim për shfrytëzim të atyre të drejtave apo benefacioneve të cilat parashihen me ligj. Pas përfundimit të listave përfundimtare, komisioni e përfundon punën e tij dhe atyre të pakënaqurve iu mbetet edhe një mundësi përmes procedurës gjyqësore të ankohen lidhur me pretendimet e tyre. Pra, jemi në përfundim të procesit dhe qysh sot ne do të fillojme me shpalljen e listave dhe secila zonë që e përfundon procesin e verifikimit, lista nënshkruhet nga ana e komendantëve të asaj zone, pra ne i quajmë nën-komisione dhe menjëherë publikohen listat e asaj zonë në ueb-faqen

zyrtare të Zyrës për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta dhe së paku në dy mediume të shkruara.

Flora Brovina – Ju faleminderit z. Çeku për këtë informatë lidhur me këtë proces të verifikimit të veteranëve të UÇK-së dhe njëherazi ju urojme që ky proces të përbylljet sa më parë dhe të gjitha ato kategori që e meritojnë t'i marrin ato beneficione që parashihen me ligj. Urojmë që në fund të këtij procesi të mos kemi fërkime apo pakënaqësi në mes të kategorive nga ata që dhanë çdo gjë që ne sot të gjëzojmë këtë liri. Fillimisht, të dëgjojmë edhe drejtorin e Zyrës për Çështjet e Kategorive të Dala nga Lufta, mandej të vazhdojmë me pyetje, nëse dikush dëshiron të parashtrojë.

Faik Fazliu - drejtor i Zyrës për Çështjet e Kategorive të Dala nga Lufta, në kuadër të Zyrës së Kryeministrat – Ju faleminderit kryetare, përshëndetje për të gjithë deputetët. Unë nuk kam çka të shtoj lidhur me procedurat të cilat i prezantoi kryetari i komisionit. Vetëm mund të themi se zyra të cilën unë e përfaqësoj, pas këtij procesi, është e obliguar që të merret me zbatimin e këtij ligji. Pas përfundimit dhe shpalljes së listave përfundimtare, këto lista do të mbesin në Zyrën për Çështjet e Kategorive të Dala nga Lufta. Më duhet t'ju informoj se veteranëve të cilëve iu takojnë beneficionet sipas ligjit, do të fillojnë t'i marrin në këtë vit. Siç e dini, për këtë vit sipas buxhetit të Kosovës janë ndarë 24 milionë mjete që janë të dedikuara për pensionet e veteranëve luftëtarë. Kurse dy kategoritë tjera, ajo e invalidëve të luftës dhe familjeve të dëshmorëve, këto beneficione janë duke i marre dhe është buxhet i veçantë për këto dy kategori. Sipas të dhënave që ne i kemi nxjerrë prej aplikacioneve, përafërsisht dalin se janë diku 11000 veta që janë të papunë dhe që mund të gjëzojnë këtë pension të veteranit luftëtar, pasi që sipas ligjit pensionin e veteranit luftëtar mund ta gjëzojë vetëm ai që nuk është në marrëdhënie pune. Pra, ky numër mund të vërtetohet saktë pas përfundimit të këtij procesi ku do të zhvillohen procedurat që parashihen, sipas Udhëzimit Administrativ që jemi duke e përgatitur, ku të gjithë janë të obliguar të sjellin dëshmi që nuk janë në marrëdhënie punë.

Agim Çeku – Ky numër ka dalë se në momentin që kanë aplikuar, në aplikacion e kanë shkruar se janë të papunë. Mirëpo, TMK-ja i ka pasur 3000 veta të cilët kanë qenë 100% luftëtarë të UÇK-së nga ky numër 1500 pjesëtarë kanë kaluar në FSK, kurse 1500 sot e gjëzojnë pensionin sipas ligjit si ish- pjesëtarë të TMK-së. Edhe pjesëtarët e FSK-së e kanë ligjin e tyre që në momentin e pensionimit të tyre, ata marrin pensionin sipas këtij ligji. Pra, ky numër prej 11000 të papunë besoj se do të jetë shumë më i vogël, pasi që këto kategori duhet të vendosin se cilin pension do të marrin, sepse kanë të drejtë të marrin vetëm një pension.

Njomza Emini – Faleminderit kryetare, faleminderit z. Çeku- kryetar i komisionit, përshëndetje për përfaqësuesin e Qeverisë, z. Fazliu, përshëndetje për mediat. Unë konsideroj se gjithë ky numër i madh që ka dalë, pra jam skeptike rrith verifikimit të veteranëve të luftës. Mirëpo, unë ju përgëzoj për punën që e keni bërë dhe uroj që këta të janë veteranë të vërtetë të luftës sipas kriterieve që janë paraparë me ligj, dhe që kjo shumë prej 24 milionësh, të shkojë për ata që me të vërtetë kanë kontribuar dhe kanë luftuar për çlirim e vendit dhe e meritojnë, pasi çdo vend i Evropës e ka një ligj që i mbron. Kërkojmë nga ju që ato aplikacione t'i shqyrtoni me kujdes se në ato aplikacione mund të ketë edhe falsifikime. Unë, me të vërtetë, dëshiroj që në fund të këtij procesi në listat përfundimtare të janë ata të cilët kanë qenë pjesë e luftës dhe kanë kontribuar për çlirim e vendit dhe të përfitojnë ato kategori që e meritojnë. Në bazë të cilave kritere dhe dëshmive apo dokumenteve ju keni bërë verifikimin e këtyre kategorive që e dëshmojnë që kanë qenë veteranë të luftës?

Flora Brovina – Ju faleminderit kolege. Unë me gjithatë konsideroj se veteranëve të luftës iu kemi mbetur borxh, sepse Ligji për veteranët e luftës në çdo shtet demokratik është ligji i parë që nxirret pas luftës dhe ne jemi vonuar që sa vite, pra e kemi vonuar procesin e verifikimit të veteranëve.

Time Kadrijaj – Faleminderit kryetare, përshëndetje për kryetarin e Komisionit, z. Çeku dhe përfaqësuesin e Qeverisë, pra drejtorin e Zyrës për Çështjet e Veteranëve të UÇK-së. Meqenëse edhe vetë një pjesë të madhe të punës e kam bërë gjatë verifikimit, për shkak se kam qenë pjesë e Komisionit për verifikimin e kategorive të invalidëve të luftës dhe për shkak se vetë kam shërbyer në luftë dhe shumicën e tyre i kam trajtuar gjatë luftës, mendoj që ka qenë mundësi e mirë e verifikimit, për faktin se edhe aplikacionet kanë qenë të ndara për tri kategoritë. Pra, ka qenë për kategorinë e familjeve të dëshmorëve për invalidët e luftës edhe për veteranët. Në aplikacion, secilit veteran i është kërkuar që të shënojë kohën e fillimit që është angazhuar dhe kohën e përfundimit, po ashtu është kërkuar se në cilin batalion ka qenë i angazhuar, në cilën njësi, kënd e ka pasur komandant, pra ka qenë mundësi e mirë e verifikimit. Për verifikimin e çdo aplikacioni është kërkuar nga ata që i ka cekuar në aplikacion që të pranojnë se a ka qenë i angazhuar në luftë dhe a ka shërbyer siç e ka deklaruar në aplikacion dhe pas kësaj vlerësoj se komisioni e ka pasur të lehtë, pasi që barra apo përgjegjësia u ka rënë direkt komandantëve. Unë theksoj se është mirë që më në fund ky proces po përfundon, i cili është dashur që të përfundojë moti, pra 15 vite pas luftës, sepse një kategori e veteranëve me të vërtetë kanë qenë në një gjendje shumë të rëndë ekonomike dhe si pasojë e kësaj ka ndodhur një numër i madh i vetëvrasjeve së veteranëve të luftës. Jam shumë e gëzuar që ky proces ka arritur në fazën përfundimtare dhe ata veteranë të cilët janë të papunë, të fillojnë t'i gëzojnë beneficionet e tyre, të cilat i meritojnë. Uroj që data 20 shkurt të jetë data përfundimtare kur do të publikohen listat dhe afati prej 30 ditësh, afati i ankesës dhe pas kësaj uroj që marsi të jetë muaji ku veteranët vetëm të fillojnë që t'i gëzojnë beneficionet e tyre.

Besa Baftiu – Faleminderit kryetare, përshëndetje për kryetarin e komisionit, z. Çeku dhe përfaqësuesin e Qeverisë, media dhe të gjithë të pranishmëve. Se kjo kategori ka qenë e nëpërkëmbur, sepse po dihet se tash janë bërë 15 vite nga përfundimi i luftës dhe kjo kategori mendoj se është shkelur nga të gjitha qeveritë e pasluftës. Është dashur që kjo kategori menjëherë pas luftës të shpërblehet për mundin dhe për sakrificën që e kanë bërë. Mendoj se edhe pse ky numër ishte prej 66500 aplikantëve, edhe pse parimisht duket se është i madhe, por mendoj se të gjithë ata njerëz që kanë kontribuar në forma të ndryshme kanë aplikuar dhe kanë menduar se ata në një mënyrë e kanë ndihmuar luftën. Tash është komisioni i cili duhet të bëjë verifikimin e secilit aplikant, të verifikojë dhe t'ua njohë statusin atyre që e meritojnë. Po ashtu, e vlerësoj shumë se njerëzit që janë të punësuar dhe e fitojnë statusin e veteranit, mos të përfitojnë pensionin e veteranit. Këtu po nisem edhe prej dy vëllezërve të mi të cilët kanë qenë pjesëtarë të UÇK-së, pra unë e vlerësoj se këta do të përfitojnë statusin e veteranit. Qytetarët që janë jashtë Kosovës dhe punojnë, a do të marrin pensionin e veteranit apo jo?

Unë besoj se edhe kjo kategori nuk është dashur që të përfitojnë këtë pension, por këta konfigurojnë se nuk janë në marrëdhënie punë në Kosovë, mirëpo që të sjellin një dëshmi që nuk janë në marrëdhënie pune as në vendin ku jetojnë. Pra, personat që kanë një marrëdhënie pune, të mos e marrin pensionin e veteranit. Edhe për vëllezërit e mi të cilët jetojnë jashtë edhe punojnë, jam që të marrin atë që iu takon, por jo edhe pagën apo pensionin e veteranit.

Hatim Baxhaku – Ju faleminderit kryetare, i nderuar z. Çeku kryetar i Komisionit për Verifikimin e Veteranëve, të nderuar deputetë dhe ju të pranishëm. Fillimisht, më lejoni t'ju falënderoj ju z. Çeku për punën e madhe që keni bërë, punë e cila ka qenë fisnikë dhe me përgjegjësi të mëdha, sepse e di që gjatë procesit të verifikimit të statusit të veteranëve jeni

ballafaquar me probleme të mëdha në kuptimin e verifikimit të vërtetësisë se a kanë qenë kontribuuves të luftës. Ne ju përgëzojmë për punën dhe njëherazi kërkojmë nga ju që mos t'ju hyni në hak askujt dhe me kujdes të bëhet ky verifikim dhe gjithsecilit për kontributin që ka dhënë t'i njihet statusi i veteranit, pavarësisht se në cilën kategori do të jenë apo a do të ketë përfitime materiale. Secili që ka aplikuar dhe mund të dëshmojë dhe të faktojë se ka qenë i angazhuar dhe ka kontribuar, pra unë vlerësoj se duhet t'i njihet statusi i veteranit. Duhet të jemi të kujdesshëm që të mos i lëndojmë ata njerëz, sepse me të vërtetë ata kanë bërë një punë e cila nuk mund t'u paguhet me asgjë dhe po ashtu duhet t'i përgëzojmë për durimin 15 vjeçar, sepse një numër i madhe i këtyre veteranëve kanë qenë të ballafaquar edhe me probleme ekonomike dhe me dinjitet i kanë përballuar të gjitha këto sfida.

Fadil Beka – Faleminderit kryetare, përshëndetje z. Çeku- kryetar i Komisionit për Verifikimin e Veteranëve të UÇK-së, përshëndetje për përfaqësuesin e Qeverisë z. Fazliu, përshëndetje për mediat dhe të nderuar kolegë deputetë. Edhe unë si parafolësit e mi ju përgëzoj për punën që keni bërë, normalisht as ne edhe as ju, si pjesëmarrës të luftës, nuk jemi të kënaqur për këtë zgjatje të këtij procesi që 15 vite mbas luftës dhe ende verifikimi nuk është përfunduar, mirëpo megjithatë siç thotë populli, më mirë vonë se kurrë. Do të ishte mirë që ta kemi një aplikacion këtu, ku shumica e njerëzve nuk janë në dijeni, për shembull siç tha kolegia znj. Emini, nuk ka nevojë dokumente, por në aplikacion kërkohen të gjitha të dhënat që ne konsiderojmë se janë të mjaftueshme për të verifikuar se a ka qenë dikush pjesëmarrës apo ajo, pra aty është komplet zinxhiri komandues, duke filluar prej togut, skuadrës, kompanisë, batalionit dhe brigadës dhe gjithsecili është kërkuar që të paraqesë se ku ka qenë i angazhuar dhe kë e ka pasur komendant. Unë konsideroj se është bërë një punë e mirë deri më tanë dhe njëherazi ju falënderoj për këtë angazhim. Po ashtu, desha të kërkojë dy sqarime nga ju. Shqetësimi i shumicës së veteranëve është se ky proces normalisht ka për të zgjatur, pra se pas publikimit të listave kemi kohën e ankesave, shqyrtimin e tyre dhe do të kalojë një kohë derisa ata të fillojnë t'i marrin beneficionet, pra prej momentit kur i njihet statusi. Për shembull, nëse në qershori do të përfundojë komplet ky proces dhe do të publikohen listat përfundimtare, a merret retroaktiv pensioni i veteranit dhe beneficionet tjera, sepse besoj se kjo iu intereson edhe veteranëve që ta dinë. Po ashtu, një pyetje për z. Fazliu që është shumë me rëndësi. Unë nuk jam saktë në dijeni se kur është themeluar kjo zyrë në kuadër të Zyrës së Kryeministratit. A do të jetë kjo zyrë e përhershme për çështjet e veteranëve të luftës gjithmonë pranë Zyrës së Kryeministratit apo do të jetë kjo zyrë derisa të përfundojë ky proces?

Shukrije Bytyçi – Faleminderit kryetare, përshëndetje për z. Çeku - kryetar i Komisionit, përfaqësuesin e Qeverisë, përshëndetje për ju deputetë, njëherazi i falënderojmë për gatishmërinë e tyre për raportim para Komisionit për të na prezantuar lidhur me procesin e verifikimit të veteranëve të UÇK-së. Me të vërtetë veteranët janë një prej kategorive më të privilegjuara të kombit. Është e vërtetë që ky proces është vonuar, por megjithatë është mirë që është miratuar Ligji për veteranët e UÇK-së, ku tashmë ata dhe familjarët e tyre do t'i gjëzojnë këto beneficionë për të gjithë ata që kanë sakrifikuar dhe kanë dhënë shumë për shtetin e Kosovës. Pra, ajo çka më intereson edhe mua është se kur do të fillojë, pra prej cilës kohë do t'ju takojë pensioni i veteranit atyre që do t'u njihet statusi i veteranit. Shpresojmë se mbas përfundimit të këtij procesi ju përsëri do të raportoni para Komisionit dhe të njihemi për së afërmi me listat përfundimtare të veteranëve.

Agim Çeku – Ju faleminderit shumë të gjithëve për vlerësimin e punës sonë, si dhe për pyetjet që ju parashtruat. Në bazë të pyetjeve dhe komenteve tuaja po e vërej se edhe ju jeni shumë të interesuar që kjo çështje të përfundojë sa më parë dhe në mënyrën më të mirë të mundshme. Këtu u fol për numra. Më duhet t'ju sqaroj se deri më tash ne i kemi verifikuar diku 23684 veteranë

luftëtarë, kurse i kemi diku 13186 pjesëmarrës të luftës, 8139 pjesëtarë të luftës dhe në komision ku kanë qenë prezent të gjithë komandantët e zonave, kryetarë dhe anëtarë të shoqatave të dala nga lufta, për neve këta numra nuk janë befasi fare dhe janë përafërt, ashtu siç i kemi pritur. Ka njëfarë tendencë që njerëzit dëshirojnë që ta minimizojnë edhe luftën edhe UÇK-së, pra UÇK-ja nuk ka qenë ushtri e vogël, nuk ka qenë ushtri guerile po ka qenë dhe ashtu ka përfunduar e dalë nga lufta, ushtri e mirëfilltë. Ushtrinë nuk e përbjegjnë vetëm luftëtarët, pra ata që janë me pushkë në dorë, por edhe një numër i madh që e mbështet ushtrinë përmes kontributit të ndryshëm politik, logistik, i financimit, i përkrahjes mediale, sektorit të shëndetësisë etj. Pra, këto kategori që kanë qenë në funksion të ushtarëve, janë të përfshira, kështu që UÇK-ja ka qenë një ushtri e madhe dhe e mirëfilltë. Unë e theksova se gjatë punës sonë jemi munduar shumë në procesin e verifikimit që të kemi sa më pak ankesa dhe të jemi sa më shumë realë, por ka qenë e pamundur se të gjithë në të njëjtën ditë të gjithë të punojmë bashkërisht dhe nuk e përjashtojmë mundësinë që të ketë edhe ndonjë gabim, por është mundësia e ankesës dhe të gjitha ato gabime mund të evitohen me kohë.

Pra, përgjegjës për statusin që do ta kenë janë komandantët e tyre dhe nuk është Komisioni Qeveritar. Ne si komision e kemi menaxhuar procesin, kurse nënshkrimin se çfarë statusi ka e jep komandanti i tij i drejtpërdrejtë. Sa i përket benefacioneve, sa do të jenë dhe kur do të fillojë, nuk është përgjegjësi e jona, pra ligji është në fuqi dhe udhëzimi administrativ shumë shpejt do të nxirret, i cili i parashev më mirë edhe më saktë lidhur me benefacionet dhe afatet. Kurse sa i përket Zyrës për Çështjen e Veteranëve, ligji i parashev një gjë të tillë dhe kjo zyrë është e përhershme. Pra, kjo zyrë është themeluar nga ana ime sa kam qenë kryeministër i Kosovës.

4. Formimi i grupit punues për monitorimin e Ligjit nr. 04/L-008, për Këshillin Ekonomiko-Social

Flora Browina – Ne si Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në planin e punës e kemi paraparë që gjatë muajit shkurt, të bëjmë monitorimin e Ligjit nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social.

Time Kadriaj – Pasi që është legjislaturë e re dhe ne si komision kemi deputetë të rinj, unë mund të udhëheq këtë grup punues dhe anëtarë të jenë të gjithë anëtarët e komisionit, që të shohin për së afërmë sesi bëhet një monitorim i ligjit. Dhe mandej edhe këta mund të udhëheqin grupet punuese në të ardhmen.

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këtë

Përfundim

- Formohet grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social. Kryetare e grupit punues do të jetë znj. Time Kadriaj, kurse anëtar të grupit punues do të jenë të gjithë anëtarët e komisionit.

5. Të ndryshme

Kryetarja – Po ju njoftoj se Komisioni për mbikëqyrjen e Financave Publike ka kërkuar që bashkërisht të mbajmë një takim të përbashkët për shqyrtimin e Raportit të auditorit të përgjithshëm për Ministrinë e Shëndetësisë.

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, nxori këtë

Përfundim

- Komisioni, më datë 24.02.2015, do të mbajë takim të përbashkët me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për shqyrtimin e Raportit të auditorit të përgjithshëm për Ministrinë e Shëndetësisë.

Kryetarja – Ju njoftoj se unë kam pasur një takim me Institutin Demokratik të Kosovës – KDI, ku kemi shqyrtuar mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen. KDI-ja ka shprehur gatishmëri përmes projektit të tyre të cilin e financon USAID-i, të na mbështesë me hulumtime parlamentare lidhur me ndonjë projektligj që e kemi në kuadër të planit të punës. Ne bashkërisht diskutuam se tek cilit projektligje mund të zhvillojnë hulumtime parlamentare. Ata kërkuan që të gjitha kërkesat e Komisionit të procedohen përmes Drejtorisë së Hulumtimeve në Kuvend.

Po ashtu, sot kemi realizuar një takim me ambasadoren e Zvicrës, znj. Krystyna Marty Lang, ku u dakorduam që bashkëpunimi në mes Ambasadës dhe Komisionit do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Temat kryesore që u diskutuan ishin sigurimet shëndetësore dhe pensionet. Nga ambasadorja u njoftuam se Zvicra përmes programeve të saj, do ta mbështetë Ministrinë e Shëndetësisë, pra prezantoi programet të cilat do t'i zhvillojnë në sektorin e shëndetësisë, si në ofrimin e trajnimeve profesionale pér menaxherët dhe stafin profesional të institucioneve të kujdesit primar shëndetësor. Pra, mbështetjen që Banka Botërore do të japë përmes Fondit të Mirëbesimit, në vlerë prej 25 milionë eurosh pér vazhdimin e reformës shëndetësore, si dhe mbështetjen e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Po ashtu, u diskutua rreth mundësisë që të dy vendet t'i zhvillojnë diskutimet e nevojshme pér nënshkrimin e marrëveshjes ndërshtetërore pér sigurimet shëndetësore, si dhe pér pensionet e qytetarëve të cilët kanë jetuar dhe ende vazhdojnë të jetojnë në Zvicër.

Kryetarja – Ju faleminderit të gjithëve pér pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:

Njësia pér Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Flora BROVINA